

KËRKESË-PADI

Përpara:

GJYKATËS SE RRETHIT GJYQESOR _____

PADITËS _____, i biri/e bija i/e _____ dhe i/e _____,
lindur më _____, në _____, banues/e në adresën: Rruga:
_____ me kartë identiteti nr. _____, numër telefoni
_____, me e-mail: _____. (Punëmarrësi)

I PADITUR _____, me adresë: _____. (Punëdhënësi)

OBJEKTI: Detyrimi i palës së paditur të shpërblejë dëmin e rrjedhur nga zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar dhe pa shkaqe të arsyeshme e kontratës së punës të përbërë prej,

- pagën e dymbëdhjetë muajve (neni 155 “ III” K. Punës)
- pagën e periudhës së njoftimit paraprak prej ____ muaj (neni 151 “2” i Kodit të Punës)
- Shpërblimin për moszbatimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, në masën e ____ pagave mujore (neni 144, pika 5 e Kodit të Punës).
- Pagesën e vjetërsisë në punë, në masën e 15 ditëve pagë, për çdo vit pune të kryer.
- Pagesën e lejes vjetore të papaguar për vitin _____, në masën e një page mujore.

BAZA LIGJORE: Nenet 140, 144, 145, 146, 149, 153 dhe 155 të Kodit të Punës;

Nenet 31, 32, 153, 154 të Kodit të Procedurës Civile,

Kontrata Individuale e Punës lidhur ndërmjet palëve në datën

E nderuar Gjykatë,

Rrethana e çështjes

Në këtë rubrikë paraqiten faktet konkrete të çështjes ku përshkruhet me hollësi lindja e marrëdhënieve të punës, momenti i lidhjes së kontratës individuale të punës; detyrat që ka patur punëmarrësi gjatë zbatimit të kontratës së punës, duke ju referuar përshkrimit të punës sipas kontratës individuale dhe rregulloreve të brendshme apo akteve të tjera të punëdhënësit.

Në vazhdim përshkruhen me hollësi momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës, veprimet, procedurat dhe afatet që ka ndjekur punëdhënësi për përfundimin e kontratës individuale të punës dhe shkaqet (nëse ka) të cilat punëdhënësi i ka vënë në dijeni punëmarrësit për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Analiza Ligjore

Ne këtë rubrike duhet te tregohet lidhja ndërmjet fakteve te pasqyruara më lart me respektimin e kërkesave të ligjit duke ju referuar në analizë dispozitave ligjore përkatëse për të mbështetur pretendimet e punëmarrësit (paditësit) kundër punëdhënësit (palës së paditur)

Në këtë rubrikë pala paditëse, duhet të argumentojë se përse e konsideron përfundimin e kontratës së punës, pa shkaqe të justifikuara (*Neni 153 i Kodit të Punës*) dhe sipas rastit, pa respektuar afatet e njoftimit (*Neni 143 i Kodit të Punës*) dhe procedurën për përfundimin e marrëdhënies së punës (*Neni 144 i Kodit të Punës*).

Lista e Provave qe i bashkëlidhen Kërkese-Padisë;

Kjo rubrike duhet te përmbajë dokumentet qe disponon paditësi ne momentin e depozitimit te kërkesë-padisë, p.sh. kontratën individuale të punës, njoftimet e punëdhënësit, si dhe çdo dokument që do konsiderohet i nevojshëm për të provuar pretendimet përpara gjykatës

Konkluzion

Në këtë rubrikë paraqitet kërkesa përfundimtare përpara gjykatës, e cila lidhet me objektin e kërkesë-padisë, pra:

Detyrimi i palës së paditur të shpërblejë dëmin e rrjedhur nga zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar dhe pa shkaqe të arsyeshme e kontratës së punës të përbërë prej,

- pagën e dymbëdhjetë muajve (neni 155 “ III” K. Punës)
- pagën e periudhës së njoftimit paraprak prej _____ muaj (neni 151 “2” i Kodit të Punës)
- Shpërblimin për moszbatimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, në masën e _____ pagave mujore (neni 144, pika 5 e Kodit të Punës).

- Pagesën e vjetërsisë në punë, në masën e 15 ditëve pagë, për cdo vit pune të kryer.
- Pagesën e lejes vjetore të papaguar për vitin _____, në masën e një page mujore.

Paditësi

Datë _____



SHERBIMI LIGJOR FALAS TIRANË